



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Tiranë më, 06.03.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2016 PËR
PROJEKTIN “PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE I”

- **Hyrje**

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I” në mbledhjen e datës 6 mars 2019.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë.

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- **Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit**

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Nëpërmjet këtij projektligji Republika e Shqipërisë do të ketë mundësi të marrë nga KfW-ja:

- Një kredi të butë, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim në vlerë të përgjithshme deri në 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro;
- Një shumë financimi prej gjithsej 2 000 000 (dy milionë) euro për masat e nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

Projekti synon të ndikojë përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët.

Mënyra e përdorimit të këtyre shumave, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedurat e dhënies së porosisë parashikohet të përcaktohen në kontratat që do të përfundohen ndërmjet KfW-së dhe marrësve të huas dhe shumës së financimit, të cilat i nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale Gjermane.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë, në kontekstin e lidhjes dhe të zbatimit të kontratave që do të lidhen ndërmjet KfW-së dhe marrësve të huave dhe shumave të financimit. Sipas marrëveshjes, tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe taksat e tatime të ngjashme indirekte që lindin në këtë kontekst mbarten nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe OSHEE sh.a.

Projektligji nuk parashikon efekte financiare shtesë.

- **Diskutimi në komision**

Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrtoi këtë projektligj, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 6 mars 2019.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të përfaqësues të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë. Deputetët në komision pasi u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit ndalën dhe diskutuan mbi objektivat dhe fazat e projektit. Deputetët kërkuar informacion lidhur me efektet

financiare të projektligjit dhe pasi morën përgjigje nga përfaqësuesit e ministrisë vlerësuan nismën e propozuar dhe nevojën për përmbushjen e objektivave të këtij projekti.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

KRYETARE

MIMI KODHELI